

FORÇA E RE DEMOKRATIKE

FORÇA E RE DEMOKRATIKE • NOVA DEMOKRATSKA SNAGA • Bul. Skenderbeu pr/bb 85360 Ulqin/Ulcinj
Tel.: +382 030 401 760 • info@forca.me • www.forca.me

Ulqin, 16.02.2025

Nr. 69/25

Sh.T. Z. Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës
Prishtinë

Mesazh urimi për Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës

I nderuar Kryeministër Kurti,

Në emrin tim dhe në emër të partisë politike shqiptare Forca e Re Demokratike ju përcjell urimet më të përzemërta për Ditën e Pavarësisë dhe 17 Vjetorin e Republikës së Kosovës.

Kosova është në dekadën e saj të dytë si shtet i pavarur dhe demokratik, dhe kemi privilegjin të ndajmë me ju krenarinë për arritjet e saj në ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe përfaqësimin dinjitoz në arenën ndërkombëtare.

Etapa e re e konsolidimit të shtetit, përparimi ekonomik dhe sfidat aspak të lehta që e presin Kosovën kërkojnë maturi dhe vizion për t'i tejkaluar me sukses, ndërsa ne mbetemi besimplotë që Kosova do t'i kapërcejë me vendosmëri.

Njëkohësisht, shpreh urimin që Republika e Kosovës të përmbyll me sukses rrugëtimin e saj integrues drejt Bashkimit Evropian dhe në të ardhmen e afërt të përmbushë kriteret për anëtarësim në NATO.

Me urimet më të mira e vëllazërore, për përparimin e mëtejshëm të Kosovës, Ju lutem pranoni shprehjen e konsideratës sime më të lartë.

Sinqerisht,

Genci Nimanbegu

Kryetar i Forcës së Re Demokratike



Genci Nimanbegu